

# RASTET PËR KRIMET E LUFTËS PRANË GJYKATAVE TË KOSOVËS (KORRIK - DHJETOR 2022)

BULETIN | KORRIK - DHJETOR 2022

Fondi për të Drejtën Humanitare Kosovë (FDHK), që nga përfundimi i konfliktit të armatosur në Kosovë, monitoron proceset gjyqësore për krimet e luftës pranë gjykatave të Kosovës. FDHK në vazhdimësi ka publikuar dhe do të publikoj analiza të rasteve dhe buletine, që do t'i shërbejnë publikut të gjerë për të qenë më të informuar mbi këto procese gjyqësore.

Në këtë buletin janë paraqitur të dhënat e përgjithshme mbi proceset gjyqësore për krimet e luftës në Kosovë, për periudhën kohore korrik - dhjetor 2022.

Gjatë kësaj periudhe, pranë gjykatave të Kosovës janë mbajtur njëzet e një (21) seanca në shkallën e parë dhe në shkallën e dytë. Ndërkaq, janë arrestuar edhe tre (3) të dyshuar për veprën penale krim i luftës kundër popullsisë civile dhe hetimet janë duke vazhduar.

## PROCEDURA PARAPRAKE:

### RASTI: PROKURORI KUNDËR EKREM BAJROVIQ

Ekrem Bajroviq është arrestuar në datën 19 tetor të vitit 2022 nën dyshimin se ka kryer veprën penale krim i luftës kundër popullatës civile gjatë muajit maj të vitit 1999 në fshatin Staradran/Starodvorane të Komunës së Istogut/Istok, gjatë asaj periudhe i dyshuari ishte polic në stacionin policor në Gjurakoc/Durakovac.

I pandehuri gjendet në paraburgim dhe hetimet janë duke vazhduar.

### RASTI: PROKURORI KUNDËR GAVRILLO MILLOSAVLEVIQ

Gavrilo Millosavleviq është arrestuar në datën 2 dhjetor të vitit 2022 nën dyshimin se ka kryer veprën penale krim i luftës kundër popullatës civile, në periudhën kohore në mes të viteve 1998-1999 në Kosovë. I pandehuri kishte ushtruar pozitën e gardianit të burgut të Dubravës, dhe dyshohet se ishte përfshirë në maltretimin dhe ekzekutimin e të burgosurve shqiptarë në burgun e Dubravës.

I pandehuri gjendet në paraburgim dhe hetimet janë duke vazhduar.

## RASTI: PROKURORI KUNDËR SLLAGJAN TRAJKOVIQ

Sllagjan Trajkoviç është arrestuar në datën 15 dhjetor të vitit 2022 nën dyshimin se ka kryer veprën penale krim i luftës kundër popullatës civile gjatë muajit maj të vitit 1999 në fshatin Reznik/Resnik të Komunës së Vushtrrisë/Vuçitrn dhe në qytetin e Vushtrrisë/Vuçitrn.

I pandehuri gjendet në paraburgim dhe hetimet janë duke vazhduar.

## GJYKIMET NË SHKALLËN E PARË

### RASTI: PROKURORI KUNDËR ÇASLLAV JOLLIQIT

Në datën 18 nëntor 2022, Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës (PSRK) ka ngritur aktakuzën ndaj të pandehurit Çasllav Jolliq, nën dyshimin se i pandehuri ka kryer veprën penale krim i luftës kundër popullatës civile gjatë periudhës mars - maj të vitit 1998, në fshatin Gjurakoc/Durakovac të Komunës së Istogut/Istok. I pandehuri në cilësinë e policit akuzohet se në bashkëkryerje me persona të tjerë ka marrë pjesë në rrahjen e tre civilëve shqiptarë.

Në datën 04 dhjetor të vitit 2022 është mbajtur seanca fillestare. Shqyrtimi kryesor në këtë rast ende nuk ka filluar.

I pandehuri gjendet në paraburgim që nga arrestimi i tij.

### RASTI: PROKURORI KUNDËR DUSHKO ARSIQIT

Zyra e PSRK në datën 2 nëntor të vitit 2022 ka ngritur aktakuzën kundër të pandehurin Arsiq. Ai akuzohet se në bashkëkryerje me pjesëtarë të tjerë të policisë serbe dhe grupeve paramilitare, gjatë periudhës së luftës në Kosovë, konkretisht prej muajit janar deri në muajin qershor të vitit 1999, ka marrë pjesë në dëbimin, plaçkitjen, dëmtimin e pronës dhe keqtrajtimin e civilëve shqiptarë të Prishtinës/Priština me rrethinë.

I pandehuri dyshohet se në datën 20 prill të vitit 1999, në fshatin Butovc/Butovac ka marrë pjesë në ekzekutimin e Brahim Shalës, në vendin e quajtur "varrezat e Maqedoncve".

Po atë ditë në të njëjtin vend, i pandehuri e ka maltretuar fizikisht dhe psikikisht të dëmtuarin A.K (në atë kohë 15 vjeçar), duke e goditur me tytën e automatikut në pjesën e shpinës. Në momentin derisa ishin duke e maltretuar A.K, është shtënë me armë zjarri në drejtim të Brahim Shala nga fshati Trudë/Trudna.

Në datën 10 nëntor të vitit 2022 është mbajtur seanca fillestare. Shqyrtimi kryesor në këtë rast ende nuk ka filluar.

I pandehuri gjendet në paraburgim që nga arrestimi i tij.

## RASTI: PROKURORI KUNDËR MUHAMET ALIDEMAJT

Zyra e PSRK në datën 29 mars të vitit 2022 ka ngritur aktakuzën kundër të pandehurin Alidemajt për shkak të dyshimit se ka kryer veprën penale krim i luftës kundër popullatës civile.

I pandehuri akuzohet se gjatë periudhës kohore në mes të 24 marsit dhe 11 qershorit të vitit 1999, gjatë konfliktit të armatosur në Kosovë, si pjesëtarë i forcave policore dhe ushtarake serbe, ka shkelur rëndë rregullat e së drejtës ndërkombëtare kundër popullsisë civile dhe pasurisë së tyre, në atë mënyrë që:

-në datën 28 mars të vitit 1999 në fshatin Izbicë/Izbica të Komunës së Skënderajit/Srbica dyshohet se i pandehuri në bashkëkryerje me pjesëtarë tjerë të forcave ushtarake dhe policore serbe ka marr pjesë dhe ka kontribuar në vrasjen e 130 civilëve shqiptarë të cilët fillimisht janë ndarë prej grave dhe fëmijëve.

-në datën 28 mars të vitit 1999 i pandehuri së bashku me pjesëtarë të tjerë të forcave policore dhe ushtarake serbe, ka marrë pjesë në trajtimin çnjerëzor, cenimin e integritetit trupor dhe shëndetit, grabitjen dhe shkatërrimin e pasurisë së popullsisë civile të fshatit Izbicë/Izbica dhe fshatrave përreth. Ashtu që fillimisht i detyruan me dhunë civilët shqiptarë që të largoheshin nga shtëpitë e tyre duke i kërcënuar me armë dhe duke i grumbulluar në një livadh në mes të fshatit.

-Në vendin e njëjtë ku janë ekzekutuar civilët shqiptarë, pas dy (2) muajve, i pandehuri së bashku me pjesëtarë të tjerë të forcave policore dhe ushtarake serbe, u kthyen sërish në fshat për ti zhvarrosur kufomat me ekskavator me qëllim të largimit të tyre në drejtim të panjohur. Pas përfundimit të luftës shumica e këtyre kufomave janë gjetur në varrezat masive në Batajnicë të Serbisë, në fshatin Suhodoll/Suvi Do të Mitrovicës/Mitrovica dhe në fshatin Novolan/Nevoljane të Vushtrrisë/Vučitrn.

Në seancën e datës 28 dhjetor të viti 2022 palët kanë parashtruar fjalët hyrëse. Seanca e radhës vazhdoi në datën 18 janar të vitit 2023 me dëgjimin e dëshmitarëve të propozuar nga prokuroria.

I pandehuri gjendet në paraburgim që nga arrestimi i tij.

## RASTI: PROKURORI KUNDËR SVETOMIR BAÇEVIQIT

Trupi gjykues i Departamentit Special të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Priština në datën 8 shtator të vitit 2022, të pandehurin Svetomir Baçeviq e shpalli fajtor për veprën penale krim i luftës kundër popullatës civile. I pandehuri u dënua me pesë (5) vite burgim se në periudhën kohore korrik - gusht të vitit 1998 në fshatin Bellopojë/Belo Polje të Komunës së Pejës/Peć e kishte marr peng të dëmtuarën Tigjë Kadrija.

Mbrojtja ka parashtruar ankesën kundër aktgjykimit të shkallës së parë dhe deri në fund të vitit 2022 gjykata e Apelit nuk ka vendosur.

# RIGJYKIMET NË SHKALLËN E PARË

## RASTI: PROKURORI KUNDËR REMZI SHALËS

Pranë Departamentit për krime të rënda të Gjykatës Themelore në Prizren është duke vazhduar gjykimi në rastin kundër Remzi Shalës të akuzuar për krim të luftës kundër popullatës civile.

Zyra e PSRK në datën 19 tetor të vitit 2016 e ka ngritur aktakuzën kundër të akuzuarit Remzi Shala në drejtim të veprës penale krim i luftës kundër popullatës civile të kryer në bashkëkryerje me kryerës të panjohur gjatë kohës së konfliktit të armatosur në Kosovë. I akuzuari ngarkohet se në datën 26 qershor të vitit 1998, në fshatin Duhël/Dulje, komuna e Suharekës/Suva Reka, me përdorimin e dhunës e ka marrë nga shtëpia Haxhi Përteshin, trupi i të cilit pas disa ditësh (1 korrik i vitit 1998) është gjetur në afërsi të rrugës rajonale në fshatin Duhël/Dulje, komuna e Suharekës/Suva Reka.

Gjatë vitit 2022 janë mbajtur gjithsej gjashtëmbëdhjetë (16) seanca gjyqësore. Brenda kësaj periudhe janë dëgjuar shtatëmbëdhjetë (17) dëshmitarë, ku gjatë dy seancave ka pasur edhe ballafaqime mes disa prej dëshmitarëve.

Gjatë periudhës korrik - dhjetor 2022 janë mbajtur tetë (8) seanca, gjatë të cilave janë dëgjuar tetë (8) dëshmitarë dhe është deklaruar i pandehuri.

## RASTI: PROKURORI KUNDËR ZORAN VUKOTIQIT (VUKOTIQ IV)

Trupi gjykues i Departamentit Special të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Priština në lëndën Prokurori kundër Zoran Vukotiqit-Vukotiq IV, në datën 11 nëntor të vitit 2022, në rigjykim e ka shpallur aktgjykimin, me të cilin të akuzuarin Vukotiq e ka shpallur fajtor për kryerjen e veprës penale krime të luftës kundër popullatës civile. I akuzuari, si pjesëtar i forcave policore të njësisë rezerve të MPB të Serbisë, në datën 22 maj të vitit 1999 gjatë luftës në Kosovë, në komunën e Vushtrrisë/Vučitrn, në bashkëkryerje me pjesëtarë të tjerë të këtij njësitit, ka marrë pjesë në dëbimin e popullatës civile shqiptare, në kryerjen e dhunës fizike dhe psikike ndaj tyre si dhe me përdorimin e dhunës dhe veprimeve të tjera çnjerëzore, duke kryer dhunim seksual ndaj një gruaje të nacionalitetit shqiptar.

Të akuzuarit i është shqiptuar dënimi me burgosje në kohëzgjatje prej dhjetë (10) vitesh. Vendimi ende nuk është i plotfuqishëm, palët kanë drejt ankese në shkallën e dytë.

# VENDIMET NGA GJYKATA E APELIT

## RASTI: PROKURORI KUNDËR GORAN STANISHIQIT

Kolegji i Gjykatës së Apelit në çështjen penale kundër të akuzuarit Goran Stanishiq, të akuzuar për kryerjen e veprës penale krim lufte kundër popullatës civile, pas mbajtjes së seancës së kolegjit, në datën 27 shtator të vitit 2022, duke vendosur lidhur me ankesën e avokatit mbrojtës i të pandehurit, morri aktgjykimin me të cilin pjesërisht e aprovoi ankesën e mbrojtësit të të pandehurit.

Aktgjykimi i Apelit e ndryshoi vetëm vendimin mbi dënimin ashtu që kjo gjykatë të pandehurin Stanishiq për veprën penale për të cilën është shpall fajtor e gjykon me dënim me burgim në kohëzgjatje prej pesëmbëdhjetë (15) vite.

Sipas gjykatës i dënuari Goran Stanishiq, në cilësinë e pjesëtarit rezervë të forcave policore të MPB të Republikës së Serbisë, gjatë periudhës 15 dhe 16 prill të vitit 1999, gjatë një sulmi të gjerë dhe sistematik të forcave ushtarake, paramilitare dhe policore serbe kundër popullatës civile shqiptare në fshatrat Sllovi/Slovinje dhe Tërbovc/Trbovce të Komunës së Lipjanit/Lipljan, në bashkëkryerje me pjesëtarë të tjerë të këtij njësi, ka marrë pjesë në dëbimin e popullatës civile shqiptare, në kryerjen e vrasjeve të trembëdhjetë (13) civilëve shqiptarë dhe në plagosjen e A1.

## GJETJET E FDHK:

-Këshilli Gjyqësor i Kosovës duhet të ndërmarrë masa urgjente që katër (4) proceset gjyqësore për krimet e luftës, të cilat janë duke qëndruar pezull në Gjykatën Themelore të Mitrovicës/Mitrovica, të fillojnë sa më parë.

-Gjykata Supreme e Kosovës, e cila është instanca më e lartë gjyqësore në Kosovë, e cila është kompetente edhe për nxjerrjen e mendimeve juridike, duhet që me rastin e vendosjes lidhur me kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë në rastin Prokurori kundër Goran Stanishiq të lëshon një vendim të detajuar dhe të kuptueshëm për palët në procedurë me qëllim të unifikimit të praktikës ndëshkimore dhe maksimumit të dënimit me burgim për veprat penale të krimeve të luftës në Kosovë.

Këtu mund të lexoni buletin për periudhën janar – qershor të vitit 2022.

Ky publikim përkrahet financiarisht nga Departamenti Federal i Punëve të Jashtme të Zvicrës përmes projektit "Avancimi i procesit të pajtimit përmes qasjes përfshirëse dhe holistike ndaj ballafaqimit me të kaluarën në Kosovë" dhe nga organizata National Endowment for Democracy përmes projektit "Promovimi i dialogut dhe të kuptuarit historik".

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e Fondit për të Drejtën Humanitare Kosovë dhe nuk pasqyron pikëpamjet e Departamentit Federal të Punëve të Jashtme të Zvicrës dhe organizatës National Endowment for Democracy.